

**Njoftimi i përqendrimit me të cilin Telemah Slovenia d.o.o. (Telemach Slovenija d.o.o.),  
Ljubljana-Crnuce, Slloveni do të fitojë kontrollin mbi T - 2 d.o.o. (T - 2 d.o.o.), Lubjanë,  
Slloveni**

**(lënda nr. 08-100/2024)**

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më 03.07. 2024, e plotësuar më 19.07.2024 në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim me të cilin Telemah Slloveni d.o.o. me seli në rrugën Brnçiçeva 49A, 1231, Lubjanë -Çrnuçe, Slloveni, synon të fitojë kontroll të pavarur mbi shoqërinë T - 2 d.o.o me seli në rrugën Verovshkova 64A, 1000 Lubjanë, Slloveni.

**Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre të biznesit**

Telemah Slloveni d.o.o. në fund të fundit është në pronësi të fondeve të këshilluara nga BC Partners, një fond investimi ndërkombëtar me seli në Londër.

Fondet BC janë ekskluzivisht investitorë financiarë, d.m.th. nuk përfshihen në çdo aktivitet biznesi të përditshëm të kompanive në të cilat investojnë, të cilat menaxhohen nga bordet e tyre të drejtorëve.

BC Partners ka një prani të regjistruar në Republikën e Maqedonisë së Veriut përmes shoqërive të mëposhtme të varura në mënyrë indirekte:

- Total TV SHPK Shkup, me seli të regjistruar në Bulevardin VMRO nr. 3, Qendër, Shkup, i cili merret me shpërndarjen e përmbajtjes së mediave përmes platformave teknike të DTH,
- DIRECT MEDIA SHPKNJP Shkup, me seli në Orce Nikolov 68/3, Qendër, Shkup, e cila merret me aktivitete të marketingut, gjegjësisht me blerje dhe shitje të hapësirës reklamuese në media të shkruara dhe elektronike, dhe
- UGI FIBER SHPKNJP Shkup, me seli në Bul. Partizanski Odredi nr. 14, Qendër, Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut, e cila merret me aktivitetet e telekomunikacionit satelitor.

T - 2 d.o.o. është një operator telekomunikacioni me seli në Lubjanë.

T - 2 d.o.o. merret në ofrimin e shërbimeve të telekomunikacionit që nga viti 2004; është regjistruar në regjistrin gjyqësor në Slloveni më 11 maj 2004.

T - 2 d.o.o. ofron shërbime të telefonisë fikse dhe mobile, akses në internet me brez të gjerë dhe shpërndarje të përmbajtjes mediatike në territorin e Republikës së Sllovenisë.

T - 2 doo është i pranishëm ekskluzivisht në Slloveni dhe nuk ofron shërbime jashtë Sllovenisë.

T - 2 doo nuk ka shoqëri të varura në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe më parë nuk ka realizuar të ardhura në Maqedoninë e Veriut.

*Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.*

*Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen edhe me faks: 02 3296 466, në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.*

24.07.2024